



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Projekti Nr. P121186

Kredia Nr.. 8211-AL

Shpall

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

Për shërbimin e konsulencës individuale

“Konsulent Lokal Prokurimesh”

(Nr. Referencës së prokurimit WRIP/CS/IC/001)

Kjo kërkesë për shprehje interesi është vazhdim i Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit për këtë projekt, publikuar në faqen e Zhvillimit të Biznesit në 25 Maj, 2010; në Njoftimin e Përgjithshëm, përditësuar në 20 Dhjetor 2012, me referencë në Zhvillimin e Biznesit Nr. WB5260-12/12.

Qeveria e Shqipërisë ka marrë një kredi në shumën ekuivalente 31 milion Euro, nga Banka Botërore, kundrejt kostos së Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, dhe synon të aplikojë pjesë të këtij fondi për pagesën e “Konsulent Lokal Prokurimesh për Ministrinë Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)”. Konsulenti i prokurimeve do të punojë me kohë të plotë. Detyra parashikohet të fillojë në Shtator 2016.

Objektivat e Detyrës

Pavarësisht se MBZHRAU ka Sektor Prokurimesh, një specialist prokurimesh me eksperiencë në projektet e financuara nga Banka Botërore do të punësohet për të garantuar që: (i) prokurimet po kryhen në përputhje strikte me kërkesat dhe udhëzimet e Bankës Botërore; (ii) ngritjen e kapaciteteve në Sektorin e Prokurimeve; dhe (c) të ndihmojë në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara brenda afateve.

Specialisti i Prokurimeve (PS) do të asistojë Koordinatorin e Projektit e Menaxherin e Projektit, dhe do të punojë ngushtë me stafin e Sektorit të Prokurimeve në Ministri për të menaxhuar aktivitetet e prokurimeve të skeduluara për Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes.

Objektivi i punës

Detyrat dhe Përgjegjësitë: Funkcionet kryesore të Specialistit të Prokurimeve do të përfshijnë si më poshtë:

- Prokurimi i mallrave, punimeve civile dhe shërbimeve në përputhje me Udhëzuesit e Bankës Botërore, Manualin e Veprimtarisë së Projektit dhe Legjislacionin shqiptar;
- Koordinimi me stafin e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit dhe Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore me qëllim përgatitjen e specifikimeve teknike dhe termave të referencës për aktivitetet e planifikuara;
- Koordinimi me stafin e prokurimeve në Sektorin e Prokurimeve në mënyrë që dokumentet të firmosen në kohë dhe në përputhje me procedurat e rëna dakort;
- Pjesëmarrje në përgatitjen dhe përditësimin periodik të planit të prokurimit të Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, kryerja e verifikimeve dhe përditësimi i tij;
- Kryerja e procedurave të prokurimit bazuar në planin e prokurimit të Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes;
- Mbajtja e sistemit të raportimit të prokurimeve në përputhje me parashikimet e Manualit Operacional të Projektit;
- Mbështetje e Koordinatorit të Projektit në përgjegjësitë e tij për monitorimin e zbatimit të kontratave;

Në përgjithësi, detyrat specifike që do të ndërmerren nga konsulenti duhet të mbulojnë të gjitha metodat e prokurimit të përcaktuara në planin e prokurimit. Kjo do të përfshijë por nuk do të limitohet në dhënien e ndihmesës praktike për:

- Përgatitjen dhe publikimin e njoftimeve të prokurimit sic aplikohen nën metodat e ndryshme të prokurimit dhe nën legjislacionin shqiptar;
- Pjesëmarrja në komisionet e vlerësimit sipas termave të përshkruara në dispozitat për komisionin e vlerësimit;
- Përgatitja e dokumentave të tenderit, kërkesës për propozim dhe dokumentave të tjerë bazuar në formularët shembuj të aprovuara për projektin, dhe në procesin e përzgjedhjes, përfshirë këtu para-ofertimin apo takimin para-propozimit, sqarimet, hapjen e ofertave, etj;
- Mbështetje administrative dhe procedurale në vlerësimin teknik dhe financiar të ofertave dhe përgatitjes së raportit të vlerësimit të ofertave në përputhje me dispozitat e Manualit Operacional të Projektit;
- Mbështetje administrative dhe procedurale në propozimet teknike dhe financiare të konsulentit dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit teknik dhe financiar në përputhje me dispozitat e Manualit Operacional të Projektit;
- Përgatitja e kontratave në përputhje me format e aprovuara për projektin;
- Negocimi i kontratës dhe firmosja
- Administrimi i përgjithshëm i kontratës dhe monitorimi;
- Verifikimi i dokumentacionit të pagesës për kontratën e furnizimit të mallrave, punimeve civile dhe shërbimeve; dhe
- Procedurat e mbylljes së kontratës dhe raportimi përfundimtar.

Kërkesat për Kualifikim

- Të ketë kryer studimet e larta për ekonomik, juridik, inxhinieri ose fusha të ngjashme;

- Të paktën 3 vjet eksperincë në prokurime me projekte të financuara nga donatorët e huaj dhe fondet publike. Preferohen kandidatët, të cilët janë familjarë me Udhëzuesit e Bankës Botërore dhe Ligjin e Prokurimit Publik;
- Njohuri shumë të mira të aplikacionit MS Office. Njohja e software-ve të tjerë përbën avantazh;
- Rrjedhshëm në gjuhwn shqipe dhe gjuhwn amgleze.

Raportimi dhe Kohëzgjatja

Specialisti i Prokurimeve do të raportojë tek dhe do të punojë nën drejtimin e Koordinatorit të Projektit dhe Menaxherit të Projektit në MBZHRAU. Ai/Ajo do të dorëzojë raporte progresive mujore dhe përditësimin mujor të planit të prokurimit. Ai/Ajo do të pozicionohet në Sektorin e Prokurimeve dhe do ti dorëzojë kopje të të gjithë raporteve edhe Drejtorit të Drejtorisë Juridike.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave fton individë të kualifikuar të tregojnë interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve. Konsulentët individual të interesuar duhet të paraqesin informacion për të treguar se kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencën e duhur për të realizuar shërbimin.

Kriteret e përzgjedhjes janë:

1- Kualifikimi i Përgjithshëm	30 pikë
2- Përshtatshmëria për Projektin	60 pikë
3- Eksperienca Specifike	10 pikë

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet në paragrafin 1.9 të *Udhëzuesit të Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nën kreditë dhe Grantet e IBRD dhe IDA, botimi Janar 2011*, ku parashtrohen politikat e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Metoda e përzgjedhjes që do aplikohet është **Përzgjedhja e Konsulentit Individual (IC)**, në përputhje me procedurat për përzgjedhjen e konsulentëve individualë të përcaktuara në *Udhëzuesin: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore, botimi Janar 2011*.

Konsulentët e interesuar mund të marrin informacione të mëtejshme në lidhje me Termat e Referencës në faqen zyrtare të MBZHRAU www.bujqesia.gov.al ose në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00 - 16:30 (E hënë – E enjte) dhe 08:00 - 14:00 të premtën.

Ilirjan Lame

Menaxher Projekti

Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri

Tel: + 355 4 2226243 - 75129

E-mail: ilirjan.lame@bujqesia.gov.al

Shprehja e interesit duhet të dërgohet më shkrim në adresën e mëposhtme:

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Z. Vojo Bregu
Sekretar i Përgjithshëm

Në zarf shkruani titullin e pozicionit për të cilin po aplikoni. Afati i fundit i pranimi të aplikimeve është 1 Shtator, 2016 ora 11.00.